



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**  
**V E N D I M**

Nr. 160 dt.22.11.1995

**PER**  
**DHENIE FONDE PER KONSERVIM**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.22.11.1995, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Seksioni i Prognozës për dhënien e një fondi konservim për ish Ndërmarrjen e Gëzof Galanterisë, meqënëse kjo po i nënshtrohet problemeve gjyqësore dhe është drejt shpërbërjes si shoqëri e përbashkët me Italianin. (Kjo shoqëri e quajtur tani “KAM – TOYS”). Ky fond do të përdoret për pagat e rojeve dhe të drejtorit. Këshilli Bashkiak, i mbështetur në udhëzimin Nr.13, dt.20.05.1994 të K.Ministrave dhe të Ministrisë së Financave,

**VENDOSI**

1. Të miratojë një fond page për tre rojet dhe përgjegjësin e tyre, në vleftën prej 15.000 lekësh.
2. Ky fond mujor i konservimit fillon nga dt.01.09.1995.

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**